



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN

Nr. 535 Prot.

Datë 16.01.2023

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr.14, dt.16.01.2023

Mbi disa masa administrative dhe procedurale në kuadër të mirëfunksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan

Mbështetur në ligjin nr. 97/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr.7905, dt.21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar, ligjin nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, udhëzimin nr.2, dt.29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimin e Përgjithshëm nr.12, datë 20.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, infomimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të miratuar me Urdhërin nr.8 datë 21.01.2021 të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, si dhe bazuar në Qarkoren e Prokurorit të Përgjithshëm nr.1682/1 prot., dt.11.01.2023 të PP,

Me qëllim :

- *Forcimin e rregullshmërisë administrative në veprimtarinë e prokurorisë ;*
- *Formalizimin dhe dokumentimin e diskutimeve, analizave dhe mbledhjeve tematike për çështje penale të caktuara, në një libër të posaçëm ;*
- *Administrimin e rregullt të regjistrave dhe vendimeve për çështjet penale ;*
- *Saktësimin e mësyres së veprimit në rastet e ndjekjes penale të dhunës së pretenduar nga policia gjatë ushtrimit të detyrës ;*
- *Evidentimin e personit përgjegjës në rast situatë problematike ;*

UDHËZOJ :

1. Në çdo rast të deklarimit të moskompetencës në hetimin e një çështje penale ose pasurore dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente, nga ana e prokurorit të çështjes dorëzohet pranë Shërbimit të Arkivit një kopje e vendimit përkatës të deklarimit të moskompetencës të çështjes penale ose referimit pasuror. Në rastet e përcjelljes për kompetencë të materialeve kallëzuese në fazë verifikimi dorëzohet një kopje e shkresës përcjellëse dhe e shkresës që ka referuar materialin kallëzues ose kallëzimin penal. Arkivistja administron vendimet dhe shkresat e sipërcituara në një dosje të veçantë për çdo vit kalendarik, sipas një rendi kronologjik.
2. Si rregull, kallëzimi penal i depozituar apo materiali kallëzues i referuar si dhe ankimet e paraqitura në seancë gjyqësore nga personat e proceduar, arrestuar/ndaluar, personat nën hetim si dhe të pandehurit ndaj punonjësve të policisë së shtetit për veprime të dhunshme, veprime arbitrare, në shpërdorim apo abuzim të detyrës apo çdo forme dhune fizike ose psikologjike të kryera në momentin e kapjes, shoqërimit apo kryerjes së veprimeve hetimore, do të ndiqen dhe në kuadër të tyre do të ushtrohet ndjekje penale nga një prokuror i ndryshëm nga prokurori i cili verifikon/heton çështjen penale ndaj viktimës së pretenduar të dhunës policore. Në këtë rast materiali i nënshtrohet shortimit elektronik në sistemin CAMS. Bashkimi ose ndarja e procedimeve penale në këtë rast i nënshtrohet një analize të detajuar mes prokurorëve të çështjeve dhe kryhet sipas disponimeve të K.Pr.Penale.

3. Në rast se prokurori për shkak të detyrës, në hetim ose në seancë gjyqësore, vihet në dijeni të pretendimeve/kallëzimeve për keqtrajtime fizike ose psikologjike nga shërbimet e policisë së shtetit apo konstaton shënja të dukshme të dhunës fizike tek personat e cituar në pikën nr.2, bën verifikimet e nevojshme, nëse e vlerëson të arsyeshme njofton titullarin e policisë për konstatimin si dhe fillon kryesisht procedim penal ose informon drejtuesin e prokurorisë për të filluar procedim penal, duke marrë masat e nevojshme për të urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të ngutshme, përfshirë edhe ekspertimin mjekoligjor.
4. Të krijohet regjistri fizik dhe elektronik i evidentimit dhe shpërndarjes së materialeve që i caktohen për kryerje të veprimeve paraprake verifikuese oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit ose shërbimit. Ky regjistër administrohet nga Zyra e Regjistrimit dhe në të pasqyrohen me rend kronologjik : nr.protokollit hyrës, data e protokollit, të dhëna përmbledhese mbi materialin, emrin e kallëzuesit dhe të të kallëzuarit si dhe veprën penale. Në këtë regjistër pasqyrohet edhe nënshkrimi i oficerit që merr materialin. Oficeri i policisë gjyqësore detyrohet që sa më shpejt të jetë e mundur dhe gjithësesi brenda 7 ditëve kalendarike të përfundojë veprimet paraprake verifikuese.
5. Të gjitha takimet, analizat, raportet, mbledhjet dhe diskutimet tematike për çështje penale të caktuara ndërmjet Drejtuesit të Prokurorisë për shkak të funksionit, prokurorit të çështjes dhe drejtuesve të shërbimeve të policisë gjyqësore pasqyrohen në një libër protokollit të veçantë i cili mbahet dhe administrohet nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe që titullohet “Libër Protokollit i Drejtuesit mbi Veprimtarinë Hetimore”.
6. Me këtë udhëzim të njihen prokurorët dhe oficerët e kësaj prokurorie, kancelarja dhe punonjësit administrativ. Një kopje e këtij urdhëri i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al. Ngarkohet specialisti TI-së me kryerjen e njoftimit.
7. Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 17.01.2023 dhe publikohet në faqen zyrtare të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

DREJTUES I PROKURORISË

Kreshnik AJAZI